QENDRA KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

Gazetë Tremujore

Edicioni Nr. 3 Dhjetor 2019

Kjo gazetë, është një publikim tremujor që pasqyron aktivitetet e Qendrës Kombëtare Burimore dhe zhvillimet më të fundit në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri, mundësitë për financim, rritje kapacitetesh e rrjetëzim për OShC-të si dhe informacione të tjera relevante nga rajoni e më gjerë.

NË KËTË EDICION

AKTIVITETET E QKB-SË

Organizatat e shoqërisë civile dhe grupe aktivistësh në mbështetje të të prekurve nga tërmeti

Studim mbi rrjetet dhe koalicionet e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri

Fuqizimi i rrjeteve & koalicioneve të OSHC-ve në Shqipëri për më shumë iniciativa e impakt

Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Akademia e OJF-ve

Ceremonia e diplomimit të pjesëmarrësve në Akademinë e OJF-ve 2019

Programe Trajnimi për OSHC-të

Takime me sektorin mbi iniciativën e Kodit të Standarteve për OSHC-të

ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTOR

Hyn në fuqi procedura e re për rimbursimin e TVSH-së për organizatat jo-qeveritare

Kërkohet transparencë, konsultim gjithëpërfshirës dhe respektim i Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për paketën ligjore "ANTI-KÇK"

Deklaratë e disa organizatave të shoqërisë civile lidhur me projektligjet e Paketës Antishpifje

Dita Kombëtare e Aktivizimit #NAD2019

Indeksit për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve në Shqipëri - Raporti 2018

Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)

Panairi "Shoqëria civile për Drejtësinë"

Tirana shpallet zyrtarisht Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022

"Shoqëria Civile në procesin e Integrimit Europian"- Program për organizatat të Ballkanit Perëndimor

Takim për koordinim e rritje të bashkëpunimit mes TACSO 3 dhe Qendrave Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

Takimi i 10të Rajonal i Koordinimit për Barazinë Gjinore dhe Konferenca për Indeksin e Barazisë Gjinore 2019

Konferencë Rajonale "Të rinjtë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", Beograd

Në mbështetje të zhvillimit të Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri

THIRRJE DHE MUNDËSI

Thirrje

Njoftime

Organizatat e shoqërisë civile dhe grupe aktivistësh në mbështetje të të prekurve nga tërmeti

Në vijim të situatës emergjente të krijuar pas tërmetit të 26 nëntorit që goditi Durrësin dhe Tiranën, duke marrë jetën e 51 qytetarëve, plagosjen e qindra të tjerëve dhe shkatërrimin e shtëpive të mijëra banorëve në Thumanë, Durrës, Vorë, Manzë, Laç e zonat përreth, organizatat e shoqërisë civile u organizuan menjëherë dhe mobilizuan burimet e tyre dhe mijëra qytetarë për të dhënë mbështetjen e kontributin e tyre në ndihmë të të prekuve.

Shumë individë, organizata, grupe organizatash dhe grupe aktivistësh të shoqërisë civile u përgjigjën që në momentet e para me ndihma për nevojat urgjente për të prekurit nga tërmeti, duke grumbulluar ushqime, veshje, batanije, dyshekë, material higjenike dhe duke ofruar ndihma mjekësore. Në ditët që pasuan, si pjesë e një ndërhyrje më të koordinuar si me institucionet qeveritare dhe ato donatore, OSHC-të filluan ofrimin e shërbimeve të mbështetjes psikologjike, trajtimin e rasteve të familjeve me probleme sociale, si dhe programe rekreative ditore për fëmijët, gratë dhe moshën e tretë pranë qendrave të akomodimit.

Mobilizimi i mijëra vullnetarëve në mbështetje të të prekurve nga tërmeti, me iniciativë individuale ose të organizuar, ishte një ndihmë shumë domethënëse, veçanërisht në ditët e para pas fatkeqësisë kur përveçse për mbështetje materiale, kishte mbi të gjitha nevojë për solidaritet e fjalë shprese.

Rrjetet sociale e platformat e ndryshme luajtën një rol të rëndësishëm në adresimin e ndihmës dhe mobilizmin e burimeve në mbështetje të grupeve të prekura. Donacione të shumta nga individë dhe organizata të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, diaspora, biznesi etj. u mblodhën përmes platformave crowdfunding.

Ndërkohë, kontributi i organizatave të shoqërisë civile në përballimin e pasojave të tërmetit vijon, përmes aktiviteteve dhe programeve të hartuara specifikisht për këtë situatë, në koordinim me institucionet shtetërore dhe me mbështetjen e donatorëve.

#ShqipëriSolidare

Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA). Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhe qëndrimet e Bashkimit Evropian.

Studim mbi rrjetet dhe koalicionet e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri



Prej vitesh në Shqipëri janë krijuar e funksionojnë disa rrjete e koalicione të organizatave të shoqërisë civile, megjithatë mungon një informacion i konsoliduar me të dhëna mbi numrin tyre, fushën e veprimtarisë, shtrirjen gjeografike, anëtarët, aktivitetet etj. Ka një nevojë të madhe për të mësuar më shumë rreth rrjeteve dhe për të kuptuar kontributin që ata mund të japin.

Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile realizuan një studim mbi këtë çështje. Qëllimi i studimit është të ofrojë një panoramë të rrjeteve dhe koalicioneve të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri, si dhe të vlerësojë kapacitetet e nevojat e tyre për të mbështetur më tej zhvillimin dhe punën e vazhdueshme të rrjeteve e koalicioneve në vend. Si pjesë e studimit është kryer hartëzimi i rrjeteve e koalicioneve të identifikuara në të gjithë vendin dhe pasaporta individuale për secilin prej tyre. Pasaportat përmbajnë informacione të vlefshme si: emri i rrjetit, fusha e veprimtarisë, misioni, anëtarët, statusi ligjor, njësia e koordinimit të rrjetit dhe kontaktet e saj. Studimi po ashtu eksploron në dinamikën e rrjetëzimit. Ai shtron pyetje dhe çel një diskutim rreth rrjeteve në kontekstin e zhvillimit.

Lexoni raportin e plotë këtu

Fuqizimi i rrjeteve & koalicioneve të OSHC-ve në Shqipëri për më shumë iniciativa e impakt

Fuqizimi i rrjeteve të organizatave të shoqërisë civile është një element i rëndësishëm i zhvillimit të shoqërisë civile në Shqipëri. Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri mbështet ndërtimin e kapaciteteve të rrjeteve dhe fuqizimin e tyre, si pjesë e objektivave të saj strategjikë për të forcuar kapacitetet e shoqërisë civile dhe për të kontribuar në krijimin e një mjedisi të favorshëm për shoqërinë civile, demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.

Në këtë kuadër Qendra lançoi në tetor një thirrje të hapur për shprehje interesi për Programin e asistencës për rrjetet, koalicionet dhe grupimet e organizatave të shoqërisë civile. Ky program do të mbështesë rrjete, koalicione dhe grupime formale dhe informale me qëllim zhvillimin e mëtejshëm të tyre dhe të çështjeve e kauzave të cilat duan të çojnë përpara në fushat ku OSHC-të kontribuojnë.

Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri

Takim prezantues dhe diskutim me Grupin e të Rinjve Impakt, të organizatës "Me Komunitetin për Ndryshim" për krijimin e bashkëpunimit dhe zhvillimin e aktiviteteve në kuadër të aktivizmit qytetar dhe vullnetarizmit

Gjatë takimit me qytetarët e Bestrovës dhe përfaqësues të Avokatit te Popullit në Fier, duke lehtësuar diskutimin për zgjidhjen e problematikës ndër vite për ujin e pishëm që ky komunitet ka dhe do të adresojë për zgjidhje

Gjatë një takimi prezantues me mësues, prindër, nxënës te shkollës "Muco Delo" në Vlorë për nevojën për angazhimin e të rinjve dhe rritjen e rolit të tyre në shoqëri

Dita Kombëtare e Aktivizmit, Shkodër – Aktivitet me të rinjë vullnetarë në Qendrat Polivalente "Mark Lula"dhe "Kiras"



Sesion informimi me të rinj të shkollës së mesme "28 Nëntori" në Shkodër, mbi vullnetarizmin dhe mobilizimin qytetar



Dita Kombëtare e Aktivizmit, Vlorë – Diskutim me të rinjtë dhe organizatat rinore për aktivizmin dhe rërndësinë e tij në shoqëri

Akademia e OJF-ve

Programi i Akademisë-së OJF-ve 2019, gjatë këtyre muajve ka vijuar me të tjera leksione mbi Sigurimin e mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat; Ngritja e fondeve dhe filantropia, dhe Qeverisja me pjesëmarrje. Lektorë me shumë eksperiencë, ekspertë në secilën prej çështjeve të sipërpërmendura por edhe të ftuar të veçantë, kanë qenë pjesë e këtyre sesioneve.

#sesioni10
"Sigurimi i mbështetjes publike dhe puna me sektorin privat - Ngritja e fondeve dhe filantropia"

#sesioni11
"Qeverisje me Pjesëmarrje.

Eksperte e ftuar në leksionin Ngritja e fondeve dhe filantropia - Znj. Eugenie Harvey, Drejtore e "The Funding Network" në UK, një rrjet ku Partnerët Shqipëri tashmë bën pjesë. Eugenie ndau informacion për rrjetin si dhe eventet onsite Crowdfunding nën logon "Rrathë dhurues" (Giving Circle), të cilat po zhvillohen në gjithë botën, së fundmi dhe në Shqipëri, si një nga mënyrat efektive të ngritjes së fondeve për çështje sociale nga komuniteti.



Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë

Kanë vijuar dhe gjatë këtyre muajve sesionet e mentorimit individul dhe në grup me pjesëmarrësit në Akademi, fokusuar në çështje të ngritjes së fondeve dhe gjenerimit të të ardhurave, menaxhimit organizativ, planifikimit strategjik dhe advokimit. Në rreth 50 sesione të zhvilluara përgjatë zhvillimit të Akademisë 2019, pjesëmarrësit janë udhëzuar dhe asistuar në hartimin e një sërë dokumentesh të rëndësishëm organizativë si politika, procedura, plane strategjike, komunikimi, ngritje fondesh etj, duke kontribuar në këtë mënyrë drejtpërsëdrejti në rritjen e standardeve të punës në organizatat e tyre si dhe të qendrueshmërisë së tyre.

Vizita Studimore

Krahas leksioneve, si pjesë e Akademisë në këto muaj janë zhvilluar dhe disa vizitat studimore pranë disa institucioneve publike dhe private. Vizitat kontribuan në rritjen e njohurive të pjesëmarrësve mbi rolin e këtyre institucioneve në mbështetje të organizatave të shoqërisë civile dhe veprimtarisë së tyre. Ndarja e praktikave të mira të bashkëpunimit ndërsektorial, në lidhje me mekanizmat e përfshirjes së sektorit në politikëbërje dhe vendimmarrje si dhe eksplorimi i burimeve alternative të financimit për OSHC-të ishte thelbi i diskutimeve mes institucioneve dhe pjesëmarrësve në Akademia 2019. Lexoni këtu mbi Vizitën Studimore

Ceremonia e diplomimit të pjesëmarrësve në Akademinë e OJF-ve 2019

Më 19 dhjetor 2019, **Partnerët Shqipëri** dhe **Qendra Kombëtare Burimore** organizuan ceremoninë e diplomimit të pjesëmarrësve në **Akademinë e OJF -ve 2019.**

Gjatë programit të Akademisë të këtij viti, 25 drejtues dhe menaxhere programesh të OJF-ve të reja por edhe të konsoliduara ndoqën një seri leksionesh, seancash mentorimi dhe vizita studimore duke shkëmbyer njohuri dhe eksperienca në nivel lokal në lidhje me çështje të zhvillimit dhe qendrueshmërisë organizative si dhe përfshirjen e sektorit në procese me pjesëmarrje.

Programe Trajnimi për OSHC-të

Gjatë këtij tremujori, Qendra Kombëtare Burimore organizoi një seri programesh trajnimi për organizatat lokale të shoqërisë civile bazuar në nevojat e tyre, identifikuar edhe si pjesë e Vlerësimi I kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri.

Në përgjigje të interesit të lartë për programe trajnimi në "Programet e mbështetjes dhe skemat e financimit të Bashkimit Evropian", Qendra vijoi organizimin e të tjera trajnimeve rajonale (në terren dhe onsite) për këto çështje, me organizata në Kukës, Tiranë, Shkodër, Vlorë, Elbasan dhe Fier. Trajnime të tjera zhvilluar gjatë kësaj periudhe ishin ato mbi "Ngritja e Fondeve dhe Gjenerimi i të Ardhurave" në Korçë e Tiranë, si dhe "Planifikimi Strategjik" në Tiranë.

Rreth 240 përfaqësues të OSHC-ve morën pjesë në këto trajnime, duke avancuar njohuritë e tyre në temat e sipërpërmendura.

Po ashtu, nisur nga nevoja e OSHC-ve dhe interesi i tyre si dhe nga ndryshimet e shumta ligjore e rregullatore të muajve të fundit, Qendra organizoi 4 trajnime on line me pjesëmarrjen e OSHC-ve nga rrethe të ndryshme të vendit, mbi kuadrin ligjor dhe trajtimin fiskal të organizatave jo-fitimprurëse.



AKTIVITETET E QKB

Takime me sektorin mbi iniciativën e Kodit të Standarteve për OSHC-të

Në vijim të eventit "Fuqizimi i llogaridhënies, transparencës dhe qendrueshmërisë së organizatave të shoqërisë civile - Kodi i Standardeve për OSHC-të", organizuar në shtator të këtij viti, Partnerët Shqipëri dhe Qendra Kombëtare Burimore organizuan gjatë këtyre muajve një seri me tryeza informimi dhe diskutimi me rreth 200 organizata të shoqërisë civile në Tiranë, Vlorë, Shkodër dhe Korçë.

Kodi i Standardeve synohet të jetë një mekanizëm vet-rregullues për sektorin që do të kontribuojë në rritjen e standardit të funksionimit të OSHC-ve, cilësinë e veprimtarisë së tyre dhe rritjen e transparencës.

Ky është fillimi i një procesi pune në bashkëpunim dhe me përfshirjen e të gjitha organizatave të shoqërisë civile të interesuara si dhe të organizatave ndërkombëtare, agjencive e donatorëve që punojnë për zhvillimin e shoqërisë civile në vend.

Duke e konsideruar këtë nismë një hap vendimtar në krijimin e standardeve për punën e sektorit si dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij, ftojmë të gjitha OSHC-të e interesuara të bëhen pjesë e këtij procesi me komentet, sugjerimet, pyetjet si dhe përfshirjen në mënyrë më të drejtpërdrejtë si pjesë e grupit të punes për këtë çështje.

Në vitin e ardhshëm do zhvillohet një punë intensive për përgatitjen e Kodit dhe mekanizmin e funksionimit të tij. Procesi do të ketë disa faza, me synimin që të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe efektiv. Në vijim të hartimit të draftit, do të zhvillohen një seri takimesh rajonale konsultuese me sektorin në të gjithë vendin. Të gjitha organizatat që do të donin të përfshihen aktivisht në këtë proces, i ftojmë të na shkruajnë në info@resourcecentre.al Lexo më shumë

Gjatë takimit me organizata të shoqërisë civile në Tiranë

Gjatë takimit me organizata të shoqërisë civile në Tiranë

Gjatë takimit me organizata të shoqërisë civile në Korçë

Gjatë takimit me organizata të shoqërisë civile në Shkodër



Gjatë takimit me organizata të Rrjetint "Youth Voice", Tiranë

Gjatë takimit me pjesëmarrësit e Akademia e OJF-ve 2019

Gjatë takimit me organizata të shoqërisë civile në Vlorë

Hyn në fuqi procedura e re për rimbursimin e TVSH-së për organizatat jo-qeveritare

FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Prej dhjetorit ka hyrë në fuqi procedura e re e rimbursimit të TVSH. Sic jeni informuar rregullisht nga Partnerët Shqipëri, kjo procedurë është produkt i një grupi pune të ngritur vjet me iniciativën e Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri dhe të përbërë nga përfaqësues të Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Rimbursimit të TVSH dhe sektorit të përfaqësuar nga Partnerët Shqipëri.

Procedura e re shënon një hap cilësor në rregullimin e plotë të rimbursimit të TVSH duke mundësuar tani çdo skemë financimi, të cdo donatori me një marrëveshje bashkëpunimi me qeverinë shqiptare, si dhe të gjitha skemat e sub-granteve. Zbatimi i kësaj procedure nënkupton de-facto përjashtimin e sektorit jo-fitimprurës nga TVSH-ja.

Lexoni për më shumë Udhëzimi i Ministrisë së Financave mbi procedurën e rimbursimit të TVSH

Kërkohet transparencë, konsultim gjithëpërfshirës dhe respektim i Kushtetutës dhe Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut për paketën ligjore "ANTI-KÇK"

KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT
ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

Nëpërmjet medias, organizatat e shoqërisë civile janë njohur në muajin e fundit, me nismën ligjore të propozuar nga qeveria për parandalimin, ndryshimin dhe marrjen e masave ndaj krimit të organizuar, terrorizmit dhe krimeve të rënda, e prezantuar publikisht si paketa speciale Anti-KÇK.

Referuar deklaratave publike të përfaqësuesve të ekzekutivit, vlerësohet se kjo nismë do të shqyrtohet në Kuvend në formën e një akti normativ me fuqinë e ligjit. Kjo do të thotë se ky akt do të futet automatikisht në programin e punës së Kuvendit, duke përshpejtuar në këtë mënyrë procedurën e shqyrtimit të tij dhe duke cënuar kështu konsultimin gjithëpërfshirës dhe transparent. Me iniciativë të Komitetit Shqiptar të Helsinkit, një grup prej 22 organizatash të shoqëria civile përmes një Deklarate të hapur, kërkojnë publikimin zyrtar të këtij projekti me qëllim që t'i krijohet mundësia të gjithë OSHC-ve, ekspertëve të fushës të interesuar por gjithashtu edhe grupeve të interesit për të shfaqur mendimet e tyre brenda afateve ligjore, para se ai të bëhet objekt shqyrtimi në procedurat parlamentare. Lexoni këtu deklaratën e plotë

Deklaratë e disa organizatave të shoqërisë civile lidhur me projektligjet e Paketës Antishpifje

Në muajin nëntor qeveria shqiptare ndërmorri në Kuvend një nismë për miratimin e një pakete projektligjesh antishpifje. Duke e konsideruara këtë nismë ligjore në cënim të lirisë së shprehjes dhe një minim të demokracisë në vend, një grup organizatash shqiptare të medias dhe shoqërisë civile, i kanë bërë thirrje qeverisë të tërheqë paketën ligjore anti-shpifje. Me anë të një Deklarate, grupi i OSHC-ve i është drejtuar dhe Kuvendit të Shqipërisë për rrëzim të menjëhershëm të projektligjit. Kjo nismë është mbështetur dhe nga organizata ndërkombëtare pjesë e "Solidarity Platform". Lexoni këtu deklaratën e plotë

Dita Kombëtare e Aktivizimit #NAD2019

Më 22 Tetor Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe Partnerët Shqipëri, i'u bashkuan Ditës Kombëtare të Aktivizimit #NAD2019 si pjesë e Panairit të Aktivizmit në "Sheshin Skënderbej" si dhe e Marshimit për të Drejtat e Njeriut!

NAD2019 këtë vit solli së bashku organizata vendore dhe kombëtare si dhe aktivistë dhe vullnetarë të shumtë, duke promovuar punën e tyre të vazhdueshme, si kontribues shumë të rëndësishëm në shoqërinë shqiptare dhe zhvillimin e vendit.

#NAD2019 u organizua në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile nga gjithë vendi, nën koordinimin e Co-PLAN dhe kontribut të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile dhe Partnerëve Shqipëri, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Tiranë.



Indeksit për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve në Shqipëri - Raporti 2018

Në një takim organizuar në Tiranë në nëntor të këtij viti, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim prezantoi gjetjet e Indeksit të USAID për Qëndrueshmërinë e OSHC-ve në Shqipëri për vitin 2018. Sipas gjetjeve, qendrueshmëria e përgjithshme e sektorit të shoqërisë civile nuk pësoi ndryshime të mëdha gjatë vitit 2018. Qendrueshmëria financiare vazhdon të jetë dimensioni më i dobët i qendrueshmërisë së #OSHC-ve si dhe vazhdon të shoqërohet nga mungesa e diversifikimit të burimeve, varësia e lartë nga donatorët ndërkombëtarë, si dhe mungesa e theksuar e aksesit në fondet publike.

Arjola Agolli, Drejtore e Programeve pranë Partnerët Shqipëri dhe Menaxhere e Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile, ishte pjesë e panelit të diskutimit në këtë takim. Në vijim të prezantimit të gjetjeve, në fjalën e saj diskutoi mbi sfidat e sektorit të OSHC-ve, veçanërisht lidhur me kuadrin ligjor e atë fiskal, qendrueshmërinë financiare të sektorit, si dhe bashkëpunimin me pushtetin qendror e vendor e pjesëmarrjen në vendimmarrje. Pjesëmarrës nga shoqëria civile, komuniteti i donatorëve, institucione shtetërore dhe media ishin të pranishëm në këtë takim. Lexoni më shumë

Mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC)

Më 12 nëntor 2019, u organizua mbledhja e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile (KKSHC). Të pranishëm për ndjekjen e takimit ishin disa përfaqësues nga OSHC, organizata ndërkombëtare dhe donatorë në vend. Çështjet kryesore të trajtuara nga folësit kryesorë dhe diskutantët mes anëtarëve të Këshillit ishin: Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të mbajtur më datë 22.6.2018; Roli i KKSHC-së në hartimin e Udhërrëfyesit të rishikuar; Ecuria e KKSHC-së në vazhdim dhe angazhimi i saj në monitorimin e Udhërrëfyesit; Promovimi i rolit të KKSHC-së si aktor kyç në orientimin e problematikave në sektor; dhe Konferenca vjetore e KKSHC, për të cilën u vendos të organizohet në një moment kur Këshilli të ketë disa rezultate të punës së tij për të promovuar. Si pjesë e mbledhjes u bë dhe prezantimi i katër anëtarëve të rinj të zgjedhur pas përfundimit të mandatit 1-vjeçar të anëtarëve të tjerë.

Për më shumë lexoni këtu

Panairi "Shoqëria civile për Drejtësinë"

Në muajin tetor u zhvillua në Tiranë panairi me titull "Shoqëria civile për drejtësinë", një nismë e Save the Children dhe delegacionit të BE. Organizatat e shoqërisë civile që punojnë në fushën e drejtësisë ishin pjesë e këtij panairi dhe ndanë me të interesuarit rezultatet e punës së tyre, gjetjet dhe rekomandimet e tyre lidhur me Reformën në Drejtësi.

Të ftuar në panair ishin dhe Z. Luigi Soreca, Ambasador i Delegacionit të BE në Shqipëri , Znj. Etilda Gjonaj, Ministrja e Drejtësisë, Znj. Naureda Llagami, Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe përfaqësues të institucioneve gjyqësore dhe shtetërore.

Tirana shpallet zyrtarisht Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022

Kryeqyteti i Shqipërisë, Tirana është shpallur fitues i çmimit "European Youth Capital 2022". Aplikimi për këtë çmim u bë nga organizatat me fokus rininë në Tiranë, me drejtimin e Kongresit Rinor Kombëtar dhe mbështetjen e Bashkisë Tiranë. Ky çmim jepet nga Forumi Rinor Evropian, i cili mes 5 qyteteve zgjodhi Tiranën si kryeqendrën e të rinjve për vitin 2022.

Kryeqyteti Evropian i Rinisë është një titull që ka për qëllim fuqizimin e të rinjve, rritjen e pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje dhe forcimin e identitetit evropian. Ky titull i jep mundësinë qytetit të Tiranës të shfaqë idetë, projektet dhe aktivitetet e tij inovative që synojnë të fuqizojnë zëra dhe të sjellin një perspektivë të re të rinjve në të gjitha aspektet e jetës së qytetit.

Ceremonia e shpalljes së çmimit u zhvillua në Amiens të Francës, qyteti që mban këtë titull për vitin 2020. Qytetet finaliste për EYC 2022 u përzgjodhën nga një panel i pavarur si Parlamenti Evropian, Komiteti i Rajoneve, Kongresi i Autoriteteve Lokale dhe Rajonale të Këshillit të Evropës, etj. Lexoni me shumë

"Shoqëria Civile në procesin e Integrimit Europian"- Program për organizatat të Ballkanit Perëndimor

Në fillim të tetorit u organizua në Kosovë edicioni i tretë i Programit "Shoqëria Civile në Procesin e Integrimit Evropian".

Rreth 18 drejtues të lartë të OSHC-ve nga rajoni, ndër të cilët Arjola Agolli, Drejtore e Programeve për Partnerët Shqipëri dhe Menaxhere e Qendrës Kombëtare Burimore ishin pjesë e këtij programi. Fokusi kryesor i programit ishin Politika e Zgjerimit dhe qasjet strategjike dhe taktike për anëtarësim të vendeve të Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian, sfida aktuale të vende të rajonit dhe të shteteve anëtare si dhe roli i shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit. Lexoni për më shumë rreth programit

Takim për koordinim e rritje të bashkëpunimit mes TACSO 3 dhe Qendrave Kombëtare Burimore për Zhvillimin e Shoqërisë Civile në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi

Në muajin nëntor në Podgoricë, u organizua një takim për shkëmbim informacioni dhe koordinim të punës mes Programit TACSO 3 dhe Qendrave Kombëtare Burimore të Shoqërisë Civile në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqi, të dyja programe këto mbështetur nga Bashkimi Evropian. Në takim morën pjesë 24 përfaqësues të OSHC-ve që shërbejnë si Qendra Burimore për shoqërinë civile në këto vende, përfaqësues të Delegacioneve të BE, përfaqësues të lartë nga DG NEAR dhe ekipi i TACSO 3.

Në janar pritet që TACSO 3 të finalizojë raportin rajonal mbi "Vlerësimin e Nevojave për Mjedisin Mundësues dhe Kapaciteteve të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë". BCSDN është përzgjedhur përmes një thirrje të hapur për hartimin e këtij raporti. Gjatë periudhës tetor-nëntor bashkë me anëtarët e rrjetit (Iniciativat Qytetare, CPCD, CRNVO, KCSF, MCIC dhe Partnerët Shqipëri) realizuan mbledhjen dhe analizën e të dhënave për secilin nga vendet. Takimi për prezantimin e gjetjeve të raportit për Shqipërinë dhe konsultimi mbi to, do të mbahet në Janar 2020. Lexo më shumë

Takimi i 10të Rajonal i Koordinimit për Barazinë Gjinore dhe Konferenca për Indeksin e Barazisë Gjinore 2019

Në kuadër të bashkëpunimit të Institutit Evropian për Barazi Gjinore (EIGE), me Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë dhe Instrumentin e Ndihmës së Para-Anëtarësimit (IPA) të Bashkimit Evropian, u organizua në Bruksel më 15-16 tetor 2019, Takimi i 10-të Rajonal i Koordinimit të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE. Qëllimi i takimit ishte të diskutohej mbi zhvillimet më të fundit dhe sfidat për barazinë gjinore, mënyrat e bashkëpunimit në rajon si dhe zhvillimet e Indekseve Kombëtare të Barazisë Gjinore në vendet e Ballkanit Perëndimor. Në kuadër të këtij bashkëpunimi, edhe Shqipëria pritet të publikojë së shpejti Indeksin Kombëtar, realizuar nga INSTAT.

Arjola Agolli, Drejtore e Programeve për Partnerët Shqipëri dhe Menaxhere e Qendrës Kombëtare Burimore ishte pjesë e këtij takimi, ku mbajti dhe një fjalë mbi sfidat kryesore dhe punën e organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri për arrijen e barazisë gjinore.

Për më shumë mbi Konferencën

Për më shumë mbi Indeksi 2019

Konferencë Rajonale "Të rinjtë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi", Beograd

Në nëntor u zhvillua në Beograd Konferenca Rajonale e Rinisë "Të rinjtë në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi". Kjo konferencë mblodhi rreth 250 përfaqësues nga OSHC dhe të rinj të rajonit, përfaqësues të qeverive të Serbisë, Shqipërisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut dhe Turqisë, përfaqësues të Delegacioneve të BE-së në këto vende si dhe donatorë e institucione të tjera partnere.

Nën sloganin #Weneedmore, në konferencë u prezantua Indeksi Rajonal i Pjesëmarrjes së të Rinjve, i zhvilluar tashmë për të 4in vit radhazi duke ofruar një panoramë të problematikave e sfidave të përfshirjes sociale, ekonomike e politike të të rinjve në rajon. Si pjesë e paneleve të konferencës, u prezantuan 5 histori inspiruese të 5 të rinjve pasionantë nga secili vend. Përfaqësuesit e institucioneve në nivel vendor e qendror patën rastin në këtë event rajonal të ndanin mendime rreth pjesëmarrjes së të rinjve në nivel kombëtar dhe lokal si dhe të diskutonin mbi perspektivën e zhvillimit për të rinjtë në rajon.

Pjesëmarrës dhe panelistë nga Shqipëria në këtë konferencë ishin përfaqësues nga Partnerët Shqipëri si bashkë implementues të projektit #YouthBanksHub për Ballkanin Perëndimor & Turqinë, përfaqësues nga disa organizata rinore si Youth Act, Epoka e Re, Qendra Sociale në Ndihmë të Njerëzve në Nevojë, si dhe përfaqësues nga Bashkia Tiranë dhe INSTAT.

Në mbështetje të zhvillimit të Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri

Në tetor u zhvillua në Tiranë një event promovimi dhe rrjetëzimi me përfaqësues të OSHC-ve që punojnë në fushën e shërbimeve, me qëllim nxitjen e modeleve të sipërmarrjeve në partneritet me biznesin dhe sektorin publik.

Evente të tilla shërbejnë si një mundësi e mirë për OSHC-të pjesëmarrëse për krijimin e kontakteve dhe rrjetëzimin me sektorët e tjerë, për prezantimin e iniciativave sipërmarrëse dhe eksplorimin e ndërtimit të partneriteteve me synim sigurimin e qendrueshmërisë së këtyre modeleve të biznesit.

Partnerët Shqipëri prej disa vitesh tashmë, si pjesë e punës së saj me sektorin, ka konceptuar dhe organizon takime të tilla që i shërbejnë ndërtimit të Marrëdhënieve dhe Ekonomisë Krijuese, duke kontribuar në këtë mënyrë në rritjen e ekonomisë sociale dhe nxitjen e zhvillimit përfshirës në vend. Lexoni më shumë

Kinfolk Coffee Library – Iniciativa sociale si masë për parandalimin e përfshirjes së të rinjve në krim.

Një tjetër biznes social ka hapur dyert e tij në nëtor, në një pronë të konfiskuar nga krimi i organizuar në Shqipëri. Kinfolk Coffee do të jetë një vend ku të rinjtë dhe të rejat nga qyteti i Durrësit dhe studentë të Universitetit Aleksandër Moisiu do të socializohen, lexojnë, studiojnë dhe organizojnë aktivitete të ndryshme social-kulturore. Kinfolk ndër të tjera do të shërbejë me aktivitetet e tij për integrimin dhe punësimin e të rinjve pjesë e Shërbimit të Provës.

Në ceremoninë e hapjes morën pjesë Z. Luigi Soreca, Ambasador i Delegacionit të BE në Shqipëri, Znj. Valbona Sako, Kryetare e Bashkisë Durrës, dhe përfaqësues nga qeveria dhe institucionet publike në Shqipëri. Znj. Juliana Hoxha, Drejtore e Partnerëve Shqipëri, theksoi rëndësinë e bashkëpunimit dhe partneritetit midis shoqërisë civile, institucioneve vendore dhe agjencive të zbatimit të ligjit duhet të ecin përpara iniciativën me një vlerë të jashtëzakonshme ekonomike, sociale dhe politike.

I pranishëm në ceremoni, Z. Luigi Soreca, Ambasador i Delegacionit të BE në Shqipëri u shpreh se "Një iniciativë e tillë i jep energji te reja jo vetëm komunitetit këtu në zonë, por edhe institucioneve vendore dhe shoqërisë civile, sepse përçon një mesazh shumë të rëndësishëm për shoqërinë ku krimi ka qenë dhe është pjesë e jetës." Për me tepër *"Organizatat shqiptare të shoqërisë civile duhet të jenë në zemër të çdo diskutimi të ardhshëm mbi përdorimin dhe menaxhimin e pasurive të sekuestruara dhe të konfiskuara në këtë vend. Dua të përgëzoj veçanërisht Partnerët Shqipëri dhe organizatat e saj vendore për guximin e tyre për t'u ngritur kundër rrjeteve kriminale në rrethana shpesh të vështira."* Lexoni më shumë







THIRRJE DHE MUNDËSI

KALENDAR TREMUJOR

Shënoni në kalendarin tuaj! Përfshihu në aktivitetet tona të ardhshme!

janar 2020

S	M	T	Ë	T	F	S
			1	2	3	4
5	6	7	8	9	10	11
12	13	14	15	16	17	18
19	20	21	22	23	24	25
26	27	28	29	30	31	

shkurt 2020

S	M	T	Ë	T	F	S
						1
2	3	4	5	6	7	8
9	10	11	12	13	14	15
16	17	18	19	20	21	22
23	24	25	26	27	28	

mars 2020

S	M	T	Ë	T	F	S
1	2	3	4	5	6	7
8	9	10	11	12	13	14
15	16	17	18	19	20	21
22	23	24	25	26	27	28
29	30	31				

Akademia e OJF-ve | Trajnime dhe Seminare për OShC-të | Aktivitete rrjetëzimi | Forume Publike dhe Evente

TAKIME E KONFERENCA

Partnerët Shqipëri disponon pranë zyrave të saj, një sallë 45 m2, të pajisur me të gjitha mjetet e nevojshme për realizimin e eventeve të ndryshme si trajnime, takime pune, konferenca etj.

Përparësitë:

Sallë e përshtatshme me ndriçim natyral, pajisje bashkëkohore, kondicionim etj.

Vendndodhje shumë e mirë

Çmim konkurrues

Mundësi rrjetëzimi dhe ekspozimi

Mundësi për webinare, trajnime e konferenca e online, deri në 25 pjesëmarrës

Ju mirëpresim!

Për më shumë informacion lutemi lexoni broshurën më poshtë. Për të rezervuar na kontaktoni në:

Cel: 00355 697889600
Tel. 00355 4 2254881
partners@partnersalbania.org



NA KONTAKTONI :

Zyra në Tiranë

Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i 10të, Ap. 73, Tiranë

(në mjediset e "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim")
Tel/Fax: +355 4 2254881

E-mail: info@resourcecentre.al

Zyra në Shkodër

Lagjja Kongresi i Përmetit, Rr. Oso Kuka, Kati i 2të, Hyrja 1, Shkoder
(në mjediset e Shoqatës "Gruaja në Zhvillim")

E-mail: shkodra@resourcecenter.al

Zyra në Vlorë

Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede Ahmet Amataj, Çerdhja 15, Kati i 2të, Vlorë

(në mjediset e Qendrës "Aulona")
Tel: +355 3 3224531

E-mail: vlora@resourcecenter.al

NA NDIQNI : @resourcecentre.al @resourcecentrealbania @resourceCSO_al @ResourceCentreAlbania

@http://www.resourcecentre.al/